

VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 6 korrik 2023

Lënda nr. 2021-01

N.M.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ("Paneli") i mbledhur më 6 korrik 2023 ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Snježana BOKULIĆ, kryesuese
Z. Petko PETKOV, anëtar zëvendësues
Znj. Marina MANCINI, anëtare

Ndihmuar nga:
Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019.

Pas shqyrtimit, u vendos si më poshtë:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa fillimisht është sjellë në vëmendjen e Panelit nga vajza e ankuesit në vitin 2020.
2. Më 24 dhjetor 2020, Sekretariati i kërkoi ankuesit të ofrojë një Autorizim për ta autorizuar vajzën e tij ta përfaqësoj atë gjatë procedurave, pasi ankuesi në atë kohë gjendej në paraburgim.
3. Ankesa është regjistruar më 4 shkurt 2021. Në procedurën para Panelit, ankuesi përfaqësohet nga vajza e tij.
4. Më 16 gusht 2022, Sekretariati kërkoi nga ankuesi që të konfirmonte se ai ishte liruar nga paraburgimi. Nëse vërtet ishte kështu, Sekretariati ka pyetur nëse ankuesi dëshironte të vazhdonte ankesën e tij. Në atë rast, atij iu kërkua të plotësonte një formular të ri ankese dhe të paraqiste një Autorizimi të nënshkruar.

5. Më 21 shtator 2022, ankuesi dorëzoi një formular të ri ankese duke përfshirë Autorizimin e nënshkruar që autorizonte vajzën e tij për ta përfaqësuar atë në procedurë. Ankuesi kërkoi që identiteti i tij të mbahej konfidencial.

II. FAKTET

6. Ankuesi ka punuar si inspektor i krimeve serioze në polici në Ferizaj, Kosovë, duke filluar nga viti 1987, përfshirë edhe kohën gjatë luftës në vitet 1998-99. Pas luftës, ankuesi u zhvendos në Novi Pazar, Republika e Serbisë, ku vazhdoi të punojë si inspektor i krimeve serioze.
7. Në korrik 2010, kur ankuesi udhëtonte për në Ferizaj, Kosovë, ai ishte arrestuar jashtë Drejtorisë së Policisë së Ferizajt dhe ishte dërguar për t'u marrë në pyetje nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i Kosovë (në tekstin e mëtejshëm "Misioni") për ngjarjet në Kosovë në vitin 1999. Ankuesi thotë se Misioni e kishte marrë në pyetje për disa orë dhe më pas e kishte liruar për shkak të mungesës së provave, duke e siguruar se ai i kishte kryer detyrat e tij në përputhje të plotë me ligjin.
8. Në një datë të pacaktuar pas korrikut të vitit 2010, ankuesi bleu një apartament në Kosovë dhe u vendos aty.
9. Më 14 qershor 2019, ankuesi u arrestua në pikën kufitare Bërnjak nga Policia e Kosovës dhe u informua se ndaj tij kishte një aktakuzë për krime lufte të supozuara të kryera nga ai në Kosovë në vitin 1999. Ankuesi akuzohet se ka urdhëruar varrimin e katër viktimave në një mënyrë që shkel të drejtën ndërkombëtare humanitare.
10. Ankuesi thekson se që nga data 14 qershor 2019, ai ka qenë i paraburgosur, fillimisht në Prishtinë dhe Prizren, dhe që nga 18 qershori 2019 në Gërdovc, në burgun e sigurisë së lartë në Podujevë.
11. Ankuesi deklaron se derisa ishte i paraburgosur në Prizren, ai ishte sulmuar nga të burgosur të tjerë në bazë të thashethemeve se dyshohej se ka kryer krime lufte kundër popullatës shqiptare. Në Gërdovc, ankuesi deklaron se kalon 22 orë në ditë i mbyllur në një qeli vetmie.
12. Si rezultat, ai thotë se ka vuajtur nga probleme të ndryshme shëndetësore. Ai shprehet se në paraburgim i është ofruar mjekim që për shkak të gjendjes shëndetësore të mëparshme nuk duhej ta merrte asnjëherë.
13. Ankuesi dhe familja e tij parashtruan disa ankesa tek instancat dhe organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare që kërkonin ndihmë në lidhje me kërcënimet ndaj jetës dhe shëndetit të ankuesit gjatë kohës së tij në paraburgim. Ankuesi ka paraqitur prova për ankesat e tilla në Zyrën e Prokurorit të Specializuar në Hagë dhe në Mekanizmin Ndërkombëtar të Mbetur të Kombeve të Bashkuara për Gjykatat Penale. Më tej, ankuesi i referohet se ka bërë ankesa të tilla në Misionin e EULEX-it, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Avokatin e Popullit të Kosovës, Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë dhe Ambasadën Amerikane në Kosovë.
14. Më 23 qershor 2022, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës (Aktgjykimi nr. Pml.nr.46/2022) ka liruar ankuesin nga të gjitha akuzat ndaj tij dhe ka urdhëruar që dënimi me burgim ndaj ankuesit të ndërpritej menjëherëshëm.

15. Po atë ditë, Gjykata Themelore e Prishtinës ka urdhëruar lirimin e menjëhershëm të ankuesit nga paraburgimi nga Burgu i Sigurisë së Lartë në Gërdovc.

III. ANKESAT

16. Ankuesi pretendon se, si rezultat i arrestimit dhe paraburgimit të tij, disa nga të drejtat e tij të njeriut janë shkelur, duke përfshirë të drejtën për gjykim të drejtë, siç mbrohet sipas nenit 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
17. Ankuesi po ashtu pretendon se jeta dhe shëndeti i tij ishin vënë në rrezik për shkak të kushteve të paraburgimit dhe mjekimit jo të duhur që ai mori gjatë kohës sa ishte në burg. Ankuesi pretendon për shkelje të neneve 2, 3 dhe 5, paragrafët 1 dhe 4, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
18. Ankuesi gjithashtu citon nenet përkatëse të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese.

IV. LIGJI

19. Përpara shqyrtimit të ankesës për meritat e saj, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh Rregullin 29(1) të rregullores së tij të punës. Kjo dispozitë thekson se Paneli mund të shpall një ankesë të papranueshme në procedura të shkurtuara, *ndër të tjera*, nëse ankesa bie jashtë juridiksionit të Panelit.
20. Sipas Rregullës 25(1) të Rregullores së Procedurës, juridiksioni i Panelit është i kufizuar në shqyrtimin e ankesave për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut nga Misioni në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv. Mandati ekzekutiv i Misionit ishte deri në qershor të vitit 2018 i kufizuar në çështje të caktuara në sektorët e policisë, drejtësisë dhe doganave dhe ky mandat ekzekutiv ishte kufizuar edhe më tutje në qershor të vitit 2018 (shih Aksionin e Përbashkët 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 mbi Rregulloren e Bashkimit Evropian i Misionit të Drejtësisë në Kosovë, EULEX-i KOSOVË dhe Vendimit të Këshillit (CFSP) 2018/856 të datës 8 qershor 2018 për ndryshimin e Aksionit të Përbashkët 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i KOSOVË).
21. Nuk është treguar dhe as argumentuar se Misioni ka qenë i përfshirë qoftë në procedurën penale kundër ankuesit apo në paraburgimin e tij. Këto procedura kryhen nga autoritetet e Kosovës nën juridiksionin e tyre, jashtë mandatit ekzekutiv të mbetur të Misionit. Paraburgimi kryhet gjithashtu nën autoritetin e autoriteteve vendore, e jo nga Misioni. Paneli në parim nuk mund të shqyrtojë procedurat gjyqësore që janë para gjykatave të Kosovës, siç përcaktohet në rregullin 25(1) të Rregullores së tij të Punës. Për më tepër, ai nuk ka juridiksion në lidhje me aspektet administrative apo gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës apo të sistemit të burgjeve. Rrjedhimisht, Paneli nuk mund të ndikojë në zhvillimin ose rezultatin e procedurave gjyqësore (shih p.sh. Z.A. *Kundër EULEX-it*, 2014-36, 29 shkurt 2016, paragrafi 17). Madje as edhe Misioni nuk mund të kontrollojë drejtpërdrejt trajtimin e personave në paraburgim.
22. Madje edhe pse Paneli pranon se çështjet e paraqitura nga ankuesi ngritin shqetësime, ato nuk bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe duket se hyjnë në kuadër të përgjegjësisë ekskluzive të autoriteteve vendore kosovare. Rrjedhimisht, ato bien jashtë kompetencave të Panelit, siç është saktësuar në Rregullën 25 të

Rregullores së tij të Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë (shih p.sh. *Shaip Gashi kundër EULEX-it*, 2013-20, 26 nëntor 2013, para.9; *Jovanka, Dragan dhe Milan Vuković kundër EULEX-it*, nr. 2013-18, 7 prill 2014, paragrafët 11-12).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë që të shqyrtoj këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë fushës së juridiksionit të tij, në kuptim të Rregullave 25(1) dhe 29(1)(d) të Rregullores së tij të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

Snježana BOKUČIĆ
Kryesuese



Petko PETKOV
Anëtar zëvendësues

Marina MANCINI,
Anëtare